

20222513673

LIGJ PËR NDRYSHIMIN DHE PLOTËSIMIN E LIGJIT PËR REVIZION TË INSTRUMENTIT PËR NDIHMË PARAADERUESE (IPA)

Neni 1

Në Ligjin për Revizion të Instrumentit për Ndhimë Paraaderuese (IPA) (“Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë” numër 66/10, 43/14, 154/15, 27/16, 190/16 dhe 83/18) në nenin 1, nenin 2 paragrafi (1) pikat 2), 3) dhe 6), nenin 3 paragrafi (1), nenin 4 paragrafi (3), nenin 5 paragrafi (2) pika 1), nenin 12, nenin 15, nenin 16 paragrafi (1) pika 1), nenin 23, nenin 30 paragrafi (1) dhe nenin 31 paragrafi (2) fjalët: “Republika e Maqedonisë” zëvendësohen me fjalët: “Republika e Maqedonisë së Veriut”.

Neni 2

Në nenin 32 në paragrafin (1) fjalia hyrëse ndryshohet si vijon: “Gjobë në shumë prej 500 deri 1.000 euro në kundërvlerë denari për subjektin e revizionit mikro tregtar; prej 1.000 deri 1 500 euro në kundërvlerë denari për subjektin e revizionit tregtar i vogël; prej 1.500 deri 2.500 euro në kundërvlerë denari për subjektin e revizionit tregtar i mesëm dhe prej 2.500 deri 3.500 euro në kundërvlerë denari për subjektin e revizionit tregtar i madh do të shqiptohet për kundërvajtje personit juridik, nëse:”.

Pas paragrafit (1) shtohet paragraf i ri (2) si vijon:

“(2) Gjobë në shumë prej 100 deri 250 euro në kundërvlerë denari do t’i shqiptohet subjektit të revizionit tregtar individual për kundërvajtje sipas paragrafit (1) të këtij neni.

Paragrafi (2) që bëhet paragraf (3) ndryshohet si vijon:

“Gjobë në shumë prej 300 deri 500 euro në kundërvlerë denari do t’i shqiptohet personit përgjegjës në personin juridik sipas paragrafit (1) të këtij neni për kundërvajtje sipas paragrafit (1) të këtij neni”.

Neni 3

Në nenin 33 paragrafi (1) ndryshohet si vijon:

“Gjobë në shumë prej 100 deri 250 euro në kundërvlerë denari do t’i shqiptohet personit fizik subjekt i revizionit, respektivisht tregtar individual subjekt i revizionit, nëse:”.

Neni 4

Neni 34 ndryshohet si vijon:

“Gjobë në shumë prej 500 euro në kundërvlerë denari do t’i shqiptohet revizorit të IPA nëse revizionin e kryen në kundërshtim me nenin 16 paragrafi (3) të këtij ligji”.

Neni 5

Në nenin 35-a, fjalët: “për personin juridik, respektivisht për tregtarin individual” fshihen.

Neni 6

Procedurat e filluara deri në ditën e hyrjes në fuqi të këtij ligji do të përfundojnë sipas dispozitave të Ligjit për Revizion të Instrumentit për Ndhimë Paraaderuese (IPA) (“Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë” numër 66/10, 43/14, 154/15, 27/16, 190/16 dhe 83/18).

Neni 7

Ky ligj hyn në fuqi ditën e tetë nga dita e botimit në “Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë së Veriut”.